

RREGULLORJA E SHOQATËS ”SHQIPONJAT DARDANE”

NENI 1: Anëtarësimi në Shoqatë

Çdo person i rritur dhe me karakter të mirë ka të drejtë të kërkojë të anëtarsohet në shoqatë, duke plotësuar më parë kushtet e mëposhme:

1. Të ketë pasion për sportin e motoçiklizmit, dhe për shoqërimin e këtij sporti në grup.
2. Të zotëroj të paktën një tip motoçikletëmbi 125 ccm, me dokumenta të rregullta qarkullimi.
3. Të zotëroj leje e drejtimit për motoçikleta.
4. Të ketë lexuar dhe rënë dakord me përmbajtjen e Statutit dhe Rregullore se Shoqatës.
5. Të jete dakord që të pagoi shumën vjetore të anëtarit që i shërben burimeve Shoqatës.
6. Të ketë mundsinë të marrë pjesë në të paktën një nga tubimet që organizon Shoqata në periudhen në vjeqare.

NENI 2: Të drejtat e Anëtarit

1. Ti mundësohet e drejta për të marrë informacion nga Kryesia e Shoqatës mbi gjendjen e të ardhurave të shoqatës,
2. Të jap mendimet e tij mbi veprimtaritë e Shoqatës, të propozoj ndryshime në rregullore, dhe të votoj në mbledhje ose tubimin e anëtarëve.
3. **Pas dy vite antarsim antari ka te drejten per kandidim ne kryesi apo ndnji posti tjetër.**

NENI 3: Kryesia e Shoqatës

1. Kryesia e Shoqatës përbëhet nga Krëetari, Nënkrëetari, Arkatari, Sekretari. Ky është organi drejtus në të cilën merren vendimet për veprimtaritë e Shoqatës. Vendimet merren me konsultimin dhe pëlqimin e shumicës të Kryesisë, ose me pëlqimin e mbi ½ se anëtarëve të Shoqatës. Kryesia, gjithashtu, drejton organizimin e të gjitha veprimtarive të Shoqatës. Në raste të veçanta ajo mund të caktoj një anëtarë për ta drejtuar një aktivitet në emër të Kryesisë.
2. Kryesisë së Shoqatës i rezervohet zëri zyrtar për lajmërimet, intervistat, ose shfaqjet publike në Shtyp, Media ose Publik, në lidhje me Shoqatën “SHQIPONJATDARDANE”.

NENI 4: Detyrat e drejtuesve

1. Kryetari i Shhoqatës

Kryetari drejton çdo tubimi dhe organizim të Shoqatës, sipas Statutit dhe Rregullorres së saj. Ai përfaqëson Shoqatën dhe lajmëron Anëtarët e saj për veprimtaritë ose tubime që organizohen të paktën tre javë përpara datës së caktuar. Në rastin e zgjedhjes së Kryesisë së re, ai vepron sipas Nenit 6 të kësaj Rregulloreje. Kryetari ka të drejtë të caktoj Nënkrëetarin ose Sekretarin e Shoqatës për të lajmëruar anëtarët e Shoqatës në vend të tij në raste tubimesh ose veprimtarish të qdo lloji.

2. Nënkrëetari

Nënkrëetari ka të gjitha atributet e Kryetarit, në rastet kur ky i fundit nuk është i pranishëm në tubi, dhe të pjesëtarit të Kryesisë së Shoqatës.

3. Sekretari dhe Arkatari

Sekretari mban dhe përmbush arkivin e Shoqatës .Në këtë arkiv përmbahen të gjitha të dhënat e Anëtarëve. Arkatari e ka edhe rolin e Thesatarit të Shoqatës. Ai mbledh antarsimin vitor që japin anëtarët dhe i depoziton në Llogarinë Bankare të Shoqatës në të cilën bashk me Kryesine ka akses. Sekretari ka për detyrë të njoftojë anëtarët, një herë në tre muaj, me gjendjen e të ardhurave të Shoqatës. Ai përpilon edhe lajmërimet e Shoqatës.

NENI 5: Selia e Shoqatës

Selia e Shoqatës përcaktohet nga Kryetari i radhës, dhe i bëhet e ditur anëtarëve të Shoqatës brenda 2 javësh pas ditës së zgjedhjes së tij në këtë funksion.

NENI 6: Kohëzgjatja e Mandatit & Votimi për Zgjedhjen e Kryesisë

1. Kryesia e Shoqatës ka një mandat trevjeçar në krye të Shoqatës. Në fund të mandatit të saj, të paktën para një muaji, anëtarët lajmrohen për nevojën e zgjedhjes së një kryesije të re, dhe të një mledhjetë anëtarëve. Të gjithë anëtarët, bashkë me kryesinë, kanë të drejtë të sugjerojnë kandidaturë, ose të kandidojnë për postet e Kryesisë së Shoqatës.
2. Votimi për zgjedhjen e Kryesisë bëhet kur të mledhur janë të paktën $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të Shoqatës. Në mbledhjen shpallën të gjitha kandidaturat për postet e Kryesisë dhe votohen sipas radhës: Kryetari, Nënkryetari, Sekretari dhe Arkatari. Kandidati që mer më shumë vota për postin e kandiduar merr funksionin që i jep anëtarësia.
3. Pas zgjedhjes së Kryesisë së re, Kryetari i sapo-zgjedhur duhet të zbatojë menjëherë Nenin 5 të kësaj rregullore.

NENI 7: Tubimet & Mbledhjet

1. Tubimet dhe mbledhjet janë aktivitete që përbëjnë dhe përmbushin qëllimet e Shoqatës. Llojet kryesore të tubimeve të shoqatës (**ose tubimeve me tjera klube**) të anëtarëve janë si më poshtë:
 - a. Tubim për udhëtim në grup. Në këtë tubim anëtarët mbledhen për të përshkruar një përmbledhje të përcaktuar nga Kryesia e Shoqatës, ose nga pëlqimi i mbi $\frac{1}{2}$ së anëtarëve. Për këtë tubim anëtarët duhet të njoftohen nga Kryesia të paktën një javë më përpara datës së saj të caktuar. Në udhëtimet anëtarët duhet të respektojnë dhe të udhëtojnë në grup sipas mënyrës së duhur, pa u ndarë nga anëtarët e tjerë. Udhëtimi në grup drejtohet nga Kryetari, i cili qëndron në fillim të kolonës, në mungesë të tij nga Nënkryetari, dhe në mungesë të dyve nga një anëtar i caktuar nga Kryesia për drejtimin e këtij udhëtimi. Në rastin kur një anëtar i ndodh aksident, të gjithë anëtarët e tjerë duhet të ndalojnë udhëtimin dhe të ndihmojnë sa të mundshëm anëtarin e aksidentuar, të bëjnë atij mundur mjekimin e shpejt duke e çuar në spitalin më të afërt nëse është e nevojshme, dhe ta ndihmojnë për transportimin e mjetit të tij. Anëtarët që nuk respektojnë përgjegjësitë e udhëtimit në grup, nuk kanë më të drejtë të jenë pjesëtarë të Shoqatës dhe përjashtohen prej saj.
 - b. Mledhje të Anëtarëve. Kryesia dhe mbi $\frac{1}{4}$ e anëtarëve të Shoqatës kanë të drejtë të kërkojnë mledhjen e saj.
 - c. Mledhja e Anëtarëve për zgjedhjen e Kryesisë. Arsyeja dhe modeliteti i kësaj mledhje përcaktohen në Nenin 6 të kësaj rregullore.

NENI 8: Burimet e Shoqatës

1. Të ardhurat e Shoqatës burojnë nga antarsija vjetërore që derdhin rregullit anëtarët e saj. Kjo kuotë është 100 SFr. (Njëçind Frënga Zvicërene). Burime të tjera të Shoqatës janë donacionët që mund të dhurojnë anëtarët, (**antaret pasiv**) amatolet e sportit të motoçiklizmit, sponzorat dhe subjekte të tjera.
2. Antarsija vjetore mund të ndryshoj në rast se propozohet nga Kryesia ose nga mbi $\frac{1}{2}$ e anëtarëve një vleftë e re, dhe nëse ajo miratohet nga mbi $\frac{1}{2}$ e anëtarëve.
3. Shoqata “Shiponjatdardane” është një shoqatë jo fitimprurëse, dhe anëtarët e saj nuk përfitojnë nga të ardhurat e saj.
 - a. Duke financuar prodhimin e bluzave, stemave, amblemave, stikareve dhe sendeve të tjera ku është e printuar amblema e Shoqatës.
 - b. Duke financuar shpenzimet administrative (web faqen) të kryesisë së shoqatës, etj.
4. Anëtari sapo anëtarsohet, zotohet që të paguaj rregullisht anëtarësinë vjetore të shoqatës dhe pajtohet me Statutin dhe Rregulloren e saj. Nëse një anëtar nuk e paguan kuotën për fundin e vitit është automatikisht vitin e ardhshëm i përjashtuar nga Shoqata.
5. Sekretari dhe Arkatari kanë për detyrë, prej fillimit të vitit deri në takimin e par oficiel në vit, të mbledhë antarsijen e të gjithëve si dhe dy herë në vit të përpilojnë një bilanc të gjendjes financiare të shoqatës.

NENI 9: Ndryshimet në Rregullore

Nenit e kësaj Rregulloreje mund të diskutohen në çdo mbledhje të anëtarëve. Në rast se propozohet ndryshim në Rregullore nga një anëtarë i shoqatës, atëherë ndiqet procedura e mëposhtme:

1. Sugjerimet apo propozimet për ndryshimin dhe përmirësimin e Rregullores shënohen me shkrim nga propozuesi, dhe i shpërndahet të gjithë anëtarëve të Shoqatës nga anëtari që ben propozim, ose nga Sekretari i Shoqatës
2. Anëtarëve u jepet dy javë kohë në dispozicion pasi të jenë njoftuar me propozimin për ndryshimin e Rregullores, dhe pas këtij afati caktohet edhe data e Mbledhjes.
3. Në mbledhjen për shqyrtimin e propozimit/propozimeve duhet të jenë të pranishëm të paktën $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të Shoqatës që të votojnë propozimin e paraqitur.
4. Nëse ka më shumë se një propozim të paraqitur në letër, dhe të gjitha hidhen në votim, atëherë to votohen sipas radhës kronologjike në të cilën janë propozuar.
5. Në mbledhjen për ndryshimin e propozimit për ndryshim të rregullores mund edhe që me konsensus, sipas mendimeve të mbi $\frac{1}{2}$ të anëtarëve të pranishëm, të ndryshohet propozimi sipas përfundimeve të diskutimit mes anëtarëve, dhe ky propozim i ndryshuar të hidhet në fund për votim mes anëtarëve.
6. Pas çdo ndryshimi eventual të Rregullores, përpilohet Rregullorja e re e Shoqatës nga Sekretari dhe i shpërndahet menjëherë të gjithë anëtarëve të shoqatës.